[Shqiptarja.com]

E premte 22 Mars 2024 - Përditësimi i fundit 16:47

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Lajmet me të lexuarat në Shqiptarja.com

1 VIDEO/ Dëmtohet karroseria e makisë me 4 persona, ndjehen me ankesa disa prej tyrëve dhe e nënë me vëllezërit e saj pasojë

2 Shqipëria gjakosi

3 Dalin FOTOS, kush janë ata dy emrat nga ata 5 persona, ndërsa ka vdekur edhe kokërdhi Tanisan të

4 Arrestohet rivali i Vis Narthës, si paditësh shfaqet ish-deputeti i KQZ-së në Kosovë

5 Mbaruhën e fshehura ta ferta, ata vrisë familjen e Ilirit, ka shumëngjyrë / Atin Juka: Ja si t'ia pabesoni

6 Abcsilent i fituesve ka fati, 7 ta shtuar e 1 fitojnë pagesat

Kronika

Shijak/ Qëllon drejt dyqanit, plumbat kapin punëtorin, shënjestra ishin pronarët e biznesit! Dyshohet konflikti për një vajzë (EMRAT)

Një plagosje me armë zjarri ka ndodhur paraditen e sotme në Shijak. Një 36-vjeçar u dërgua në spital, jashtë rrezikut për jetën. Ikurimi i konfliktit mësohet të ketë qenë një vajzë. Autori kishte për qëllim të gjuante me armë drejt pronarëve të biznesit ku punonte i plagosuri.

HOROSKOPI

Aldo Mustafa
22 Mars, 11:55 | Përditësimi: 22 Mars, 16:29

Share

SHIJAK- Një plagosje me armë zjarri ka ndodhur paraditen e sotme në Shijak. Sipas njoftimit të policisë, rreth orës 11:15, është plagosur në këmbë Enidor Dedja, 36 vjeç, banues në Shijak. Ai ndodhet në spital në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Shërbimet e policisë kanë bërë të mundur identifikimin e autorit të dyshuar të plagosjes, shtetasit Arbër Hoxha, 30 vjeç, banues në Durrës dhe po vijon puna për kapjen e tij.

Report Tv mëson se ngjarja ndodhi në vendin e punës së Dedjas, një pikë shitje për pjesë makinash, por ai nuk ka patur lidhje me konfliktin. Autori Arbër Hoxha i cili tashmë është në kërkim, një natë më parë është konfliktuar me pronarët e biznesit ku punon Dedja.

Sh .COM

LEXO EDHE:
Dibër, tentoi të kryejë vrasje për motive të dobëta, arrestohet 30-vjeçari i shpallur në kërkim (EMRI)

Ai ka shkuar mëngjesin e sotëm dhe ka qëlluar me armë, por plumbat nuk kanë kapur pronarët, vëllezërit Domi, por kapën Enidor Dedjan.

Ndërkohë bëhet me dije se plumbat kanë kapur edhe xhamat e një autobusi pranë dyqanit i cili për momentin nuk ishte funksional dhe nuk kishte njeri brenda.

Autori u largua nga vendngjarja me një makinë 'Ford Fiesta'. Ndërkohë janë proceduar dhe marrë në pyetje dy vëllezërit, pronarë të biznesit ku ndodhi plagosja në këmbë e Enidor Dedjas.

Burime për Report Tv bëjnë me dije se 'molla e sherrit' mes Arbër Hoxhas dhe vëllezërve Fabio dhe Albano Domi ka qenë një femër.

Në vendngjaje bëhet me dije se janë mbledhur 20 gëzhoja nga dy lloje armësh, njëra pistoletë TT dhe tjetra Berreta, të cilat janë përdorur gjatë konfliktit.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 15:32
Plagosja e 36-vjeçarit në Shijak, 'molla e sherrit' ka qenë një vajzë, në vendngjarje u gjetën 20 gëzhoja

Një vajzë duket se ka qenë 'molla e sherrit' që çoi në plagosjen e 36-vjeçarit i cili punonte për vëllezërit Domi, thonë burime për gazetarin e Report Tv, Aldo Mustafa. Arbër Hoxha mbrëmjen e djeshme është konfliktuar me Fabio dhe Albano Domi, dy vëllezërit të cilët janë pronarët e dyqanit të aksesoreve të makinave ku ndodhi ngjarja.

Nga burimet pranë hetuesisë bëhet me dije se shkak ka qenë një konflikt për motive të dobëta që lidhej me një vajzë, por ende nuk bëhen të qarta "marrëdhëniet" përkatëse me të renë, ndërkohë që po punohet për arrestimin e të riut i cili pas hapjes së zjarrit është arratisur.

Sakaq, në vendngjarje janë mbledhur të paktën 20 gëzhoja nga dy lloje armësh, njëra pistoletë TT dhe tjetra Berreta, të cilat janë përdorur gjatë konfliktit midis palëve.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 13:52
Detaje nga të shtënat në Shijak, autori kishte konflikt me pronarët e biznesit ku punonte i plagosuri

Detaje të reja nga plagosja në Shijak paraditen e sotme, ku mbeti i plagosur Enidor Dedja.

Report Tv mëson se ngjarja ndodhi në vendin e punës së Dedjas, një pikë shitjeje për pjesë makinash, por ai nuk ka patur lidhje me konfliktin. Autori Arbër Hoxha i cili tashmë është në kërkim, një natë më parë është konfliktuar me pronarët e dyqanit ku punon Dedja.

Ai ka shkuar mëngjesin e sotëm dhe ka qëlluar me armë, por plumbat nuk kanë kapur pronarët, vëllezërit Domi, por kapën Enidor Dedjan. Ndërkohë bëhet me dije se plumbat kanë kapur edhe xhamat e një autobusi pranë dyqanit i cili për momentin nuk ishte funksional dhe nuk kishte njeri brenda.

Autori i plagosjes u largua më pas nga vendngjarja me një automjet tip 'Ford Fiesta'. Ndërkohë janë proceduar dhe marrë në pyetje dy vëllezërit pronar të biznesit ku ndodhi plagosja në këmbë e Enidor Dedjas.

G.K/Shqiptarja.com

Share

G.K/S.G/Shqiptarja.com

TAG: arbër hoxha enidor dedja shijak plagosur Durrës

Ndalohet riprodhimi i kësaj shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:
Debati për Zgjedhoren, a u intereson partive ndryshimi i ligjit elektoral?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

13 kg heroinë nga Durrësi drejt Italisë, dërgohen për gjykim pronari dhe shoferi i autobusit! Dosja dhe përgjimet
21 Mars, 16:47

Punësimet në ushtri, nis rekutrimi i të rinjve në Durrësi! Koloneli: Paga të mira për ushtarët, po rritet interesi
Aldo Mustafa
21 Mars, 12:45

Durrës, arrestohet 30-vjeçari, iu gjetën 116 mijë € në makinë, dyshohet të ardhura nga krimi (EMRI+VIDEO)
21 Mars, 12:05

Siguria kibernetike, Tafa: Shqipërisë i mungojnë 170 ekspertë
20 Mars, 14:55

'Arbër Hoxha do jetë surprizë, Broja me patjetër në Europian?' Shpëtim Duro për Report TV: Sylvinho në një pozicion të vështirë
20 Mars, 14:13

'Vrasja e Gentian Beţjas, arrestohet një prej autorëve! Në pranga edhe pronari i njetit me të cilin u larguan ekzekutorët nga Fushë Kruja! Detajë që i zbuloi
20 Mars, 10:18

Greqi, klienti qëllon me thikë kuzhinierin shqiptar se nuk i pëlqeu pjata! Dalin pamjet
20 Mars, 08:37

Makina përplas policin e Rrugores në Durrës, dalin pamjet: Efektivi i shtrirë të vijat e bardha i rrethuar nga kolegët (VIDEO+EMRI)
19 Mars, 19:58

Krujë, sekuestrohen 3 mijë farë kanabisi, në pranga 26-vjeçari (EMRI)
19 Mars, 12:13

Fushë Krujë/ Ekzekutimi i Gentjan Beţjas, plumba dhe në qishtat e këmbëvet Kërkohen të pyetem dhe anëtarët të fisit Bamë
19 Mars, 11:45

26 futbollistë nën urdhrat e Sylvinhos, sot kombëtarja me grupin e plotë! Hoxha stërvitet për herë të parë si kuqezi (VIDEO)
19 Mars, 11:03

Krujë/ Vrau foshnjën duke e hedhur në lumë, 42-vjeçarja kyç gojën! Mjeku: S'ka ardhur kurrë për vizitë
Julian Shota
19 Mars, 09:30

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje